




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. Dep.	03-02 /DPK
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	02
	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
	01-1193/16
	Data Datum Date
	22.03.2016
	PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragafi 1.1), nenit 5 (paragafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.03.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-02-4638/15, për zyrtarin e lartë z. Besnik Dërmaku, Udhëheqës i Prokurimit në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4638/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Besnik Dërmaku, Udhëheqës i Prokurimit në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Besnik Dërmaku, Udhëheqës i Prokurimit në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor figuron si pronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 22.02.2016 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkresë z. Besnik Dërmaku, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtaret e AKK-së për tu njoftuar për situatën në të cilën gjendet.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z. Besnik Dërmaku, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet qe posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z. Besnik Dermaku, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetur se biznesi ne fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe nuk ka qen i informuar se kjo situatë është ne kundërshtim me ligjin në fuqi, ndërsa na ka njoftuar se aj aktualisht nuk është duke ushtruar funksionin publik pasi qe është i suspenduar nga puna, por është zotuar se brenda afatit ligjor do te bez ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

Me datën 18.03.2016, nga z. Dërmaku, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Besnik Dërmaku nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin privat me emër Barnatore "ARONIA-PHARM" me nr.70976463.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Besnik Dërmaku, Udhëheqës i Prokurimit në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dukë bërë ndryshimet e parapara me ligj, duke u larguar nga personi i autorizuar ne biznesin privatë janë krijuar rrëthana të reja dhe është shëmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

